



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 5, DATË 29.01.2020

PËR

ÇELJEN E GARËS PËR LËSHIMIN E LICENCAVE LOKALE TË SHËRBIMIT
PROGRAMI AUDIOVIZIV

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, neneve 60 dhe 67 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Çeljen e procedurës për lëshimin e 2 (dy) licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë. (Qarqet Tiranë dhe Durrës).
2. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Fier.
3. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Korçë.
4. Shpalljen në mënyrë publike të çeljes së procedurës për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA